



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:138100
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05612505

CAP.nr.304/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtarin Individual Besnik Feka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N. A. nga P. (me numër personal ...), të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S. K., avokat në P., ndaj debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (SHSKUK - QKUK) në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së debitorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë CPC.nr.967/23, të dates 19.01.2024, me datë **24.04.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr. 967/23, të dates 19.01.2024, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, CPC.nr. 967/23, të dates 19.01.2024, ka vendosur më sa vijon: REFUZOHET, prapësimi i debitorit të përmbartimit: SHSKUK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit CPC.nr.967/23, dt.18.09.2023 mbi caktimin e përmbartimit, si i pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar kreditori, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore, me propozim që ankesa të refuzohet dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 194, lidhur me nenin 208

dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 08.06.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit e ka caktuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore, në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për caktimin e përmbartimit, debitori ka ushtruar prapësim i cili me aktvendimin e atakuar është refuzuar si i pa bazuar, duke arsyetuar se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar tërësisht si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, është titull përmbartimor dhe si i tillë i plotëson kushtet e parapara në nenin 21, nenin 22 para. 1.2, nenin 23 para.2, nenin 24 paragrafi 3 si dhe nenin 27 para.1 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë ky dokument me të drejtë trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbartim. Në bazë të nenit 71 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, e të cilat shkaqe po që ekzistojnë, e pengojnë përmbartimin e lejuar nga gjykata. Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së përcaktohet se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimin nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilin do të argumentohet ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së. Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësisht dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit, për arsye se me nenin 6 paragraf 4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë (Ligji nr. 2002/9), përcaktohet se: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit”. Me nenin 144 paragraf 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji nr. 05/L-031), përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: njoftimin e palës me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka lejuar përmbarimin dhe refuzuar prapësimin e debitorit, pasi që në këtë rast përmbarimi mund të lejohet edhe atëherë kur vendimi i dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin, për çka në këtë rast ankesa e paraqitur në procedurë administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspenziv gjegjësisht nuk e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij, andaj edhe në këtë drejtim mbi bazën e këtij vendimi mund të lejohet përmbarimi, pasi që ankesa e paraqitur nuk e ka ndaluar ekzekutimin.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbarimore ”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAP.nr.304/2024, me datë 22.04.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka